

Sektori i Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP

PROGRAMI I KURSIT

“OPERATOR I KONTROLLIT TË PANELIT”

(Kodi: PK-X-1-15)

Tiranë, Mars 2015

PROGRAMI I KURSIT

“OPERATOR I KONTROLLIT TË PANELIT”

(PK-X-1-15)

I. Profili Profesional i Operator i kontrollit të panelit

a) Karakteristikat e Operatorit të kontrollit të panelit

Operatori i kontrollit të panelit do të jetë i aftë të kryejë **detyra** profesionale në repartin e përpunimit të materialeve dhe shkrirjes në uzina apo fabrika të posaçme, duke punuar ngushtësisht me vëzhguesin dhe pjesën tjetër të punonjësve. Ai është përgjegjës për monitorimin dhe garantimin e parametrave të proceseve të punës gjatë përpunimit dhe shkrirjes së materialeve. Ai i'u përgjigjet sinjaleve të alarmit, duke ndërmarrë veprimet e duhura korrigjuese, si dhe manovron për sigurimin e parametrave teknik të procesit të shkrirjes e të derdhjes së materialit në përputhje me standardet e duhura. Në raste të veçanta, ai mund të kryejë izolimin apo ndalimin e proceseve të punës për të garantuar operacione të sigurta dhe efikase.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, operatori i kontrollit të panelit duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet bazë të metalurgjisë, proceset dhe organizimin e punës në metalurgji, rregullat e sigurisë së punës në metalurgji, dokumentacionin e operimeve të kontrollit të panelit, veglat pajisjet dhe makineritë që përdoren në metalurgji për përpunimin e metaleve dhe aktivitete që kryhen në furrë etj.

Suksesi i operatorit të kontrollit të panelit në këtë profesion është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: përgjegjshmëria e lartë, mospërdorimi i pijeve alkoolike, gjakftohtësia, kujdesi, shkathhtësia, përqendrimi, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e Operatorit të kontrollit të panelit.

Profesioni i Operatorit të kontrollit të panelit është i lidhur ngushtë me punimet që kryhen në repartin e përpunimit të materialeve në metalurgji. Ai mund të punësohet në uzina apo fabrika të përpunimit të materialeve në funksione dhe pozicione pune që kanë të bëjnë me punimet e kontrollit të panelit

Operatori i kontrollit të panelit mund të hyjë fillimisht në profesion si ndihmës punëtor. Me përvojë pune dhe me kualifikim shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e punëtorit të kualifikuar në derdhje. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një operator i kontrollit të panelit/panelist mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në përgjegjës turni apo nivel teknologu. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit të metalurgjisë.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Operator të kontrollit të panelit

Në përfundim të Kursit për Operator të kontrollit të panelit, kursantët do të jenë të aftë të:

- përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin e punimeve në repart.
- bëjnë organizimin e vogël të punës dhe mbikëqyrjen e grupit që drejtojnë.
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në repart.
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe masat e sigurisë në raste emergjente në punë.

- përdorin dhe mirëmbajnë mjetet dhe mjedisin e punës.
- kryejnë kontrollin fillestar të parametrave kryesorë të furrës.
- kryejnë manovrime për ruajtjen e parametrave kryesorë të furrës.
- mbajnë evidenca për kontrollet e kryera.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për Operator të kontrollit të panelit

Pjesëmarrësit në Kursin për Operator të kontrollit të panelit duhet të kenë përfunduar një arsim të mesëm, ku do të preferohej ai profesional, të jenë të aftë fizikisht e mendërisht dhe të kenë përvojë pune si punëtorë në repartet e përpunimit të materialeve.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për Operator të kontrollit të panelit

Kursi ka një kohëzgjatje prej 300 orësh mësimore, ku 1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për Operator të kontrollit të panelit

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e operatorit të kontrollit të panelit	MK-29-012-15	60 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti tregon veçoritë e profesionit të operatorit të kontrollit të panelit. 2. Kursanti përshkruan konceptet bazë të metalurgjisë. 3. Kursanti përshkruan konceptet bazë që lidhen me mirëfeksionimin e furrës, pajisjeve dhe makinerive. 4. Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet dhe aparaturat e panelit qendror. 5. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në sektorin përkatës.
2	Kontrolli fillestar i parametrave të furrës	MK-29-013-15	90 orë mësimore Rekomandohet: 5 % Teori 85% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti bën organizimin e vogël për punën në sektor. 2. Kursanti kryen kontrollin fillestar në panel të parametrave kryesorë të furrës. 3. Kursanti kontrollon dozimin e materialeve dhe ngarkesës së furrës në kompjuter. 4. Kursanti kontrollon funksionimin e pajisjeve të tjera nëpërmjet treguesve të sinjalistikës. 5. Kursanti kryen kontrollin fizik të furrës.
3	Manovrime për ruajtjen e parametrave kryesorë të furrës	MK-29-014-15	150 orë mësimore Rekomandohet: 5% Teori 85% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti regjistron periodikisht parametrat kryesorë të furrës. 2. Kursanti manovron me parametrat për ngarkimin e furrës. 3. Kursanti manovron me parametrat për zgjatjen periodike të elektrodave gjatë punës. 4. Kursanti zbaton kartën teknologjike për kohën e derdhjes së materialeve të shkrira nga furra. 5. Kursanti stakon dhe ritakon furrën në raste avarish të rënda.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktoret e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MMSR.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Operator i kontrollit të panelit.

1. Moduli “Hyrje në profesionin e operatorit të kontrollit të panelit”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E OPERATORIT TË KONTROLLIT TË PANELIT	(MK-29-012-15)
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me (a) veçoritë e punimeve në përpunimin e materialeve, (b) konceptet e parimet bazë ku mbështetet puna e operatorit të kontrollit të panelit, (c) konceptet bazë që lidhen me mirëfuksionimin e furrës, pajisjeve dhe makinerive, (ç) përshkrimin e mjedisit, mjetet e aparaturat e panelit qendror, si dhe (d) rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në repartet e punës së përpunimit të metaleve.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të kenë punuar si punëtorë të përpunimit të materialeve.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti tregon veçoritë e profesionit të operatorit të kontrollit të panelit. Përmbajtja: - Detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së operatorit të kontrollit të panelit. - Mundësitë e punësimit të operatorit të kontrollit të panelit. - Mjedisi dhe kushtet e punës së operatorit të kontrollit të panelit. - Organizimi i vogël i punës në repartin/sektorin përkatës. - Kërkesat profesionale të operatorit të kontrollit të panelit. - Karriera profesionale e operatorit të kontrollit të panelit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë detyrat dhe veprimtaritë kryesore të operatorit të kontrollit të panelit; - të tregojë mundësitë e punësimit të operatorit të kontrollit të panelit; - të përshkruajë mjedisin dhe kushtet e punës së operatorit të kontrollit të panelit; - të analizojë organizimin e vogël punës në repartin përkatës; - të tregojë kërkesat profesionale për operatorin e kontrollit të panelit;	

-
- të theksojë shkallët e karrierës profesionale të operatorit të kontrollit të panelit;

RM 2 Kursanti përshkruan konceptet bazë të metalurgjisë.

Përmbajtja:

- Rëndësia e përpunimit të materialeve.
- Përbërja kimike e materialeve.
- Llojet e materialeve të ngarkesës së furrës.
- Njohuri bazë të analizave kimike të materialeve që do të shkrihen dhe produkteve.
- Llojet e pajisjeve dhe makineritë që përdoren gjatë përpunimit të materialeve..
- Ndërtimi dhe funksionimi i përgjithshëm i furrës.
- Procesi teknologjik i shkrirjes.
- Përgatitja e materialeve dhe dozimi i tyre.
- Parametrat kryesorë teknik të transformatorit (fuqia, rryma, shkallët e punës, tensioni etj).
- Treguesit kryesorë të procesit teknologjik normal të shkrirjes në furnat përkatëse.
- Shkeljet kryesore të funksionimit normal të furrës.
- Procesi i derdhjes së materilave të shkrira nga furra.
- Llojet dhe fuksionimi i elektrodave (vetpjekëse të mbushura dhe të gatshme).
- Zgjatja e elektrodave dhe eliminimi i avarive në to.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë objektin e metalurgjisë;
- të theksojë rëndësinë e përpunimit të materialeve në vendin tonë;
- të përshkruajë përbërjen kimike e materialeve bazë dhe ndihmëse;
- të përshkruajë llojet e materialeve të ngarkesës së furrës;
- të përshkruajë rëndësinë e kryerjes së analizave kimike të materialeve që do të shkrihen dhe produkteve;
- të tregojë llojet dhe funksionin e pajisjeve dhe makinerive që përdoren gjatë procesit të përpunimit të materialeve;
- të tregojë ndërtimin dhe funksionimin e përgjithshëm të furrës;
- të përshkruajë se si ndodh procesi teknologjik i shkrirjes së materialeve;
- të përshkruajë se si përgatiten materialet dhe se si bëhet dozimi i tyre;
- të përshkruajë parametrat kryesorë teknik të transformatorit (fuqia, rryma, shkallët e punës, tensioni etj);
- të përshkruajë treguesit kryesorë të procesit teknologjik normal të shkrirjes së materialeve;

- të analizojë anomalitë kryesore që ndikojnë negativisht në funksionimin normal të procesit të shkrirjes në furrë;
- të përshkruajë procesin e derdhjes së materialeve të shkrira;
- të përshkruajë llojet dhe funksionimin e elektrodave: vetpjekëse të mbushura dhe të gatshme;
- të përshkruajë se si realizohet zgjatja e elektrodave dhe si eliminohen avaritë e ndryshme në to;

RM 3 Kursanti përshkruan konceptet bazë që lidhen me mirëfunksionimin e furrës, pajisjeve dhe makinerive.

Përmbajtja:

- Bazat e mekanikës që lidhen me mirëfunksionimin e furrës, pajisjeve dhe makinerive.
- Llojet e avarive për shkaqe mekanike.
- Bazat e elektrikës që lidhen me mirëfunksionimin e furrës, pajisjeve dhe makinerive.
- Llojet e avarive të furrës për shkaqe elektrike.
- Njohuri të përgjithshme për sistemin e ujit.
- Njohuri të përgjithshme për sistemin e vajit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë bazët e mekanikës lidhur me mirëfunksionimin e furrës, pajisjeve dhe makinerive;
- të tregojë cilat janë llojet e avarive të furrës për shkaqe mekanike;
- të përshkruajë bazat e elektrikës në lidhje me mirëfunksionimin e furrës, pajisjeve dhe makinerive;
- të tregojë cilat janë llojet e avarive të furrës për shkaqe elektrike;
- të përshkruajë se si funksionon sistemi i ujit në sektorin përkatës;
- të përshkruajë se si funksionon sistemi i vajit në sektorin përkatës;

RM 4 Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet dhe aparaturat e panelit qendror.

Përmbajtja:

- Mjedisi dhe kushtet e punës në panel.
- Rëndësia, llojet e pajisjeve mbrojtëse individuale.
- Dëmet që shkaktohen nga mospërdorimi i pajisjeve mbrojtëse individuale.
- Funksionimi i aparaturave në panelin qendror.
- Sinjalizuesit e sistemit ftohës – ujit dhe mënyra e manovrimit me to.
- Sinjalizuesit e sistemit të vajit dhe mënyra e manovrimit me to.

- Sinjalizuesit e ajrim-ventilimit dhe mënyra e monoverimit me to.
- Sinjalizuesit e sistemit të komandimit të dozimit dhe mënyra e manovrimit me to.
- Mënyrat e kujdesjes për mjedisin, mjetet dhe materialet e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mjedisin dhe kushtet e punës në panel;
- të listojë pajisjet mbrojtëse individuale dhe të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të tyre gjatë punës;
- të theksojë dëmet që shkaktohen nga mospërdorimi i pajisjeve mbrojtëse individuale;
- të përshkruajë funksionimin e aparaturave në panelin qendror si: pultin e komandimit, aparatet treguese të fuqisë, rrymës, tensionit energjisë etj;
- të tregojë sinjalizuesit e sistemit ftohës – ujit dhe mënyrën e manovrimit me to;
- të tregojë sinjalizuesit e sistemit të vajit dhe mënyrën e manovrimit me to;
- të tregojë sinjalizuesit e ajrim-ventilimit dhe mënyrën e manovrimit me to;
- të tregojë sinjalizuesit e sistemit të komandimit të dozimit dhe mënyrën e manovrimit me to.
- Të përshkruajë mënyrat e kujdesjes për mjedisin, mjetet dhe materialet e punës të panelit qendror;

RM 5 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në sektorin përkatës.

Përmbajtja:

- Rëndësia e sigurimit teknik në sektorin përkatës.
- Rreziqet kryesore, shkaqet e tyre dhe mënyrat e mënjanimit në sektorin përkatës.
- Rregullorja e sigurimit teknik në lidhje me repartin.
- Dëmet nga moszbatimi i rregullores së sigurimit teknik.
- Rreziqet nga gazet shpërthyes dhe helmuese, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga rryma elektrike dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga zjarri dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga mbilodhja në punë, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga keqpërdorimi i mjeteve të punës, masat për mënjanimin e tyre.
- Rregullorja e mbrojtjes së mjedisit në uzinë apo fabrikë.
- Masat për mbrojtjen e mjedisit nga punimet në uzinë apo fabrikë.

- Dëmet në mjedis nga moszbatimi i rregullores së mbrojtjes së mjedisit në usina apo fabrika.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të theksojë rëndësinë e sigurimit teknik në sektorin përkatës;
- të përshkruajë rreziqet kryesore në sektorin përkatës, shkaqet dhe mënyrat e menjanimit të tyre.
- të përshkruajë rregulloren e sigurimit teknik që duhet të zbatohet në sektorin përkatës;
- të përshkruajë dëmet që shkaktohen nga moszbatimi i rregullores së sigurimit teknik në sektorin përkatës;
- të theksojë rreziqet që shkaktohen nga gazet shpërthyes e helmuese, si dhe masat për menjanimin e tyre;
- të përshkruajë rreziqet shkaktohen nga rryma elektrike dhe masat për menjanimin e tyre;
- të përshkruajë rreziqet që shkaktohen nga zjarri dhe masat për menjanimin e tyre;
- të përshkruajë rreziqet nga mbilodhja në punë dhe masat për menjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga keqpërdorimi i mjeteve të punës dhe masat për menjanimin e tyre.
- të demonstrojë masat dhe veprimet për zbatimin e rregullores së sigurimit teknik në sektorin përkatës;
- të argumentojë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit në sektorin përkatës;
- të përshkruajë dëmet që i shkaktohen mjedisit nga punimet në sektorin përkatës, si dhe masat për mbrojtjen e tij;
- të përshkruajë rregulloren e mbrojtjes së mjedisit në uzinë apo fabrikë;
- të përshkruajë masat për mbrojtjen e mjedisit nga punimet në uzinë apo fabrikë;
- të përshkruajë dëmet që shkaktohen në mjedis nga moszbatimi i rregullores së mbrojtjes së mjedisit në uzinë apo fabrikë;
- të theksojë masat dhe veprimet për zbatimin e rregullores së mbrojtjes së mjedisit në uzinë apo fabrikë;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës në uzina apo fabrika të përpunimit të materialeve (vizita mësimore).
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantëve duhet t'u jepen detyra për mbledhje të informacioneve në lidhje me proceset e punës në uzinat e përpunimit të materialeve.

	- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore në lidhje me sigurimin teknik në uzinë/fabrikë dhe gjatë punës në sektorin përkatës. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në repart. - Komploti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në repart. - Makete të pajisjeve të punës në repart. - Komploti i materialeve dhe mjeteve për të garantuar masat e sigurisë në punë në uzina të përpunimit të materialeve. - Komplete të pajisjeve mbrojtëse individuale. - Rregullore të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në uzinat e përpunimit të materialeve. - Katalloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Kontrolli fillestar i parametrave të furrës”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KONTROLI FILLESTAR I PARAMETRAVE TË FURRËS	(MK-29-013-15)
Qëllimi i modulit	Një modul që i afëson kursantët për: (a) organizimin e vogël të punës, (b) kontrollin fillestar të parametrave kryesorë të furrës, (c) dozimit të materialeve, (ç) treguesve të tjerë të sinjalistikës së funksionimit të pajisjeve të tjera, si dhe (d) kontrollit fizik të furrës.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet: 5% Teori; 85% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të kenë punuar si punëtor të përpunimit të materialeve. Të kenë përmbyshur modulën MK-29-012-15.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti bën organizimin e vogël për punën në sektor. Përmbajtja: - Kuptimi dhe rëndësia e organizimit të vogël të punës në sektor. - Rolet dhe detyrat e anëtarëve të grupit të vogël të punës në sektor. - Marrja e urdhërit dhe e udhëzimeve të punës nga teknologu. - Ndarja e detyrave midis anëtarëve të grupit të vogël të punës. - Marrja e masave për zbatimin e urdhërit dhe udhëzimeve të dhëna nga teknologu. - Marrja e dhënies së informacionit ndërmjet anëtarëve të tjerë të grupit të vogël të punës. - Mbikqyrja e antarëve të grupit të vogël gjatë punës në sektor. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë kuptimin dhe të argumentojë rëndësinë e organizimit të vogël të punës në sektor; - të përshkruajë rolet dhe detyrat e antarëve të grupit të vogël të punës në sektor; - të njihet me urdhërin e punës nga teknologu dhe të analizojë atë; - të bëjë ndarjen e detyrave të punës antarëve të grupit; - të marrë masa për zbatimin e urdhërit dhe udhëzimeve të dhëna nga teknologu; - të marrë e të japë informacion në mënyrë të pandërprerë me antarët e tjerë të grupit të vogël të punës ;	

-
- të mbikqyrë vazhdimisht anëtarët e grupit të vogël gjatë punës në sektor ;

RM 2 Kursanti kryen kontrollin fillestar në panel të parametrave kryesorë të furrës.

Përmbajtja:

- Veshja e uniformës dhe e pajisjeve mbrojtëse të punës.
- Kontrolli fizik i mjedisit të punës ku operohet në panel.
- Kuptimi dhe rëndësia e parametrave kryesorë të furrës.
- Kontrolli fillestar i vlerave të fuqisë së furrës.
- Kontrolli fillestar i vlerave të tensionit të furrës.
- Kontrolli fillestar i vlerave të rrymës së furrës.
- Regjistrimi i të dhënave të kontrollit fillestar.
- Krahasoni i vlerave të lexuara me standardin.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit fillestar të parametrave kryesorë të furrës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë patjetër uniformës e punës dhe pajisjet mbrojtëse të punës si: kaska, syzet, dorëzat etj;
- të kryejë kontrollin fizik të mjedisit të punës ku operohet në panel;
- të përshkruajë kuptimin dhe rëndësinë e parametrave kryesorë të furrës si: fuqia, rryma dhe tensioni;
- të kontrollojë vlerat fillestare të fuqisë së furrës;
- të kontrollojë vlerat fillestare të tensionit të furrës;
- të kontrollojë vlerat fillestare të rrymës së furrës;
- të regjistrojë saktë të dhënat në regjistrin përkatës;
- të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit fillestar të parametrave kryesorë të furrës;

RM 3 Kursanti kontrollon dozimin e materialeve dhe ngarkesës së furrës në kompjuter.

Përmbajtja:

- Veshja e uniformës dhe e pajisjeve mbrojtëse të punës.
- Kontrolli fizik i mjedisit të punës ku operohet.
- Kuptimi dhe rëndësia e dozimit të materialeve dhe ngarkesës së furrës.
- Kontrolli i shënimeve të lëna nga teknologu.
- Krahasoni/verifikimi i të dhëna nga teknologut me ato në kompjuter.
- Vëzhgimi i ecurisë së procesit të ngarkimit të furrës.
- Konstatimi i rasteve të fuksionimit jonormal të procesit teknologjik dhe ndryshimit të vlerave të dozimit në këto raste.
- Lajmërimi i teknologut në rastet e konstatuara të

ndryshimit të vlerave të dozimit.

- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të dozimit të materialeve dhe ngarkesës së furrës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë patjetër uniformës e punës dhe pajisjet mbrojtëse të punës si: kaska, syzet, dorëzat;
- të bëjë kontrollin fizik i mjedisit të punës ku operohet;
- të përshkruajë kuptimin dhe rëndësinë e dozimit të materialeve dhe ngarkesës së furrës;
- të bëjë kontrollin e shënimeve të lëna nga teknologu lidhur me dozimin e materialeve dhe ngarkesës së furrës;
- të krahasojë/verifikojë të dhëna nga teknologu me ato në kompjuter;
- të vëzhgojë ecurinë e procesit të ngarkimit të furrës, sipas kartës teknologjike;
- të konstatojë rastet e funksionimit jo normal të procesit teknologjik dhe të ndryshimit të vlerave të dozimit, në me kartën teknologjike;
- të lajmërojë teknologun për rastet e konstatuara dhe ndryshimit të vlerave të dozimit;
- të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të dozimit të materialeve dhe ngarkesës së furrës;

RM 4 Kursanti kontrollon funksionimin e pajisjeve të tjera nëpërmjet treguesve të sinjalistikës.

Përmbajtja:

- Veshja e uniformës dhe e pajisjeve mbrojtëse të punës.
- Kontrolli fizik i mjedisit të punës ku operohet.
- Rikujtimi i treguesve të sinjalistikës në panelin qendror.
- Kontrolli fizik i pajisjeve të sistemeve përkatëse.
- Kontrolli i pajisjeve elektrike.
- Kontrolli i pajisjeve të sistemit ftohës.
- Kontrolli i pajisjeve të sistemit të vajit.
- Kontrolli i pajisjeve të sistemit të ajrim-ventilimit.
- Kontrolli i treguesve të shkallës së transformatorit.
- Rregjistrimi i të dhënave nga treguesit e sinjalistikës.
- Lajmërimi tek eprorët në rastet e evidentimit të parregullsive.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të treguesve të tjerë të sinjalistikës për funksionimin e pajisjeve të tjera.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë patjetër uniformës e punës dhe pajisjet mbrojtëse të punës si: kaska, syzet, dorëzat etj;
- të kryejë kontrollin fizik të mjedisit të punës ku kryhet kontrolli;
- të rikujtojë kuptimin e treguesve të sinjalistikës të funksionimit të pajisjeve të tjera të panelit qendror;
- të kryejë kontrollin e pajisjeve elektrike, sipas parametrave teknologjike;
- të kryejë kontrollin e pajisjeve të sistemit ftohës, sipas parametrave teknologjike;
- të kryejë kontrollin e pajisjeve të sistemit të vajit, sipas parametrave teknologjike;
- të kryejë kontrollin e pajisjeve të sistemit të ajrim-ventilimit, sipas parametrave teknologjike;
- të kryejë kontrollin e treguesve të shkallës së transformatorit, sipas parametrave teknologjike;
- të rregjistrojë saktë të dhënat e treguesve të tjerë të sinjalistikës të funksionimit të pajisjeve të tjera;
- të lajmërojë në kohë përgjegjësin e turnit dhe elektromekanikun për parregullësitë e evidentuara;
- të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të funksionimit të pajisjeve të tjera me anë të treguesve të sinjalistikës;

RM 5 Kursanti kryen kontrollin fizik të furrës.**Përmbajtja:**

- Veshja e uniformës dhe e pajisjeve mbrojtëse të punës.
- Kontrolli i elektrodave.
- Kontrolli i kapseve të elektrodave.
- Kontrolli i shkarkimeve të sistemit ftohës.
- Kontrolli me sy të lirë i aktivitetit të furrës.
- Lajmërimi të eprorët në rast evidentimi të anomalive.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit fizik të furrës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë patjetër uniformës e punës dhe pajisjet mbrojtëse të punës si: kaska, syzet, dorëzat etj;
- të kryejë kontrollin e elektrodave, sipas kartës teknologjike;
- të kryejë kontrollin e kapseve të elektrodave, sipas kartës teknologjike;
- të kryejë kontrollin e shkarkimeve të sistemit ftohës – kolektorit, sipas kartës teknologjike;
- të kontrollojë me sy të lirë aktivitetin e furrës, duke

gjykuar nga intensiteti, gjatësia e ngjyra e flakës;
përçueshmëria e gazrave në këmbanën e furrës, skuqja ose jo e elektrodave etj.;

- të lajmërojë në kohë përgjegjës in e turnit dhe personat specialist për parregullësitë e evidentuara;
- të zbatojë me përkikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit fizik të furrës.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset reale të punës në repartin e përpunimit të materialeve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore si dhe demonstrimet e veprimeve për organizimin e punës, kryerjen e kontrolleve fillestare të parametrave kryesorë të furrës, dozimit të materialeve, treguesve të tjerë të sinjalistikës së fuksionimit të pajisjeve të tjera, si dhe të kontrollit fizik të furrës në repartin e përpunimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për organizimin e vogël të punës, kryerjen e kontrolleve fillestare të parametrave kryesorë të furrës, dozimit të materialeve, treguesve të tjerë të sinjalistikës së fuksionimit të pajisjeve të tjera, si dhe të kontrollit fizik të furrës, në repartin e përpunimit të metaleve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur nga instruktori, dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për zbatimin e masave të sigurisë gjatë kryerjes së veprimtarive, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset reale të punës në repart.
 - Komplet i materialeve dhe mjeteve për të kryer kontrollin fillestar të parametrave të furrës.
 - Komplete të pajisjeve individuale mbrojtëse.
 - Modele të urdhërave të punës dhe të librave të kontrollit të repartit.
 - Katalloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Manovrimet për ruajtjen e parametrave kryesorë të furrës”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MANOVRIME PËR RUAJTJEN E PARAMETRAVE KRYESORË TË FURRËS	(MK-29-014-15)
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për (a) regjistrimin periodik të parametrave kryesorë të furrës, (b) manovrimint me parametrat e ngrakesës së furrës, (c) manovrimin me parametrat për zgjatjen e elektrodave gjatë punës, (ç) zbatimin e kartës teknologjike për kohën e saktë të derdhjes së materialeve të shkrira, si dhe (d) stakimin dhe ritakimin e butonit të furrës në raste avarish të rënda.	
Kohëzgjatja e modulit	150 orë mësimore Rekomandohet: 5% Teori; 80% Praktikë; 15% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të kenë punuar si punëtor i përpunimit të materialeve. Të kenë përmbyllur modulën MK-29-012-15.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti regjistron periodikisht parametrat kryesorë të furrës. Përmbajtja: - Veshja e uniformës dhe e mjeteve individuale të mbrojtjes në punë. - Kontrolli fizik i vendit të punës. - Rikujtimi i parametrave kryesorë të furrës: fuqia, rryma, presioni dhe tensioni. - Regjistrimi periodik i vlerave të fuqisë së furrës. - Regjistrimi periodik i vlerave të rrymës së furrës. - Regjistrimi periodik i vlerave të tensionit të furrës. - Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit të punës gjatë regjistrimit periodik të vlerave të parametrave kryesorë të furrës. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën e punës dhe mjete mbrojtëse si : kaskë, syze, dorëza etj; - të kryejë kontrollin fizik të vendit të punës, sipas Rr.S.T; - të rikujtojë parametrat kryesorë të furrës si: fuqinë, rrymën dhe tensionin; - të regjistrojë periodikisht vlerat e fuqisë së furrës sipas kartës teknologjike; - të regjistrojë periodikisht vlerat e rrymës së furrës sipas kartës teknologjike; - të regjistrojë periodikisht vlerat e tensionit të furrës, sipas	

-
- kartës teknologjike;
 - të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë regjistrimit periodik të parametrave kryesorë të furrës.

RM 2 Kursanti manovron me parametrat për ngarkimin e furrës.

Përmbajtja:

- Veshja e uniformës dhe e mjeteve individuale të mbrojtjes në punë.
- Kontrolli fizik i vendit të punës.
- Marrja në dorëzim e turnit të punës.
- Leximi i urdhërave dhe udhëzimeve të lëna nga teknologu.
- Shtimi dhe pakësimi i ngarkesës së furrës.
- Plotësimi i fletë-parametrit dhe kartelën e materialeve që hyjnë në furrë.
- Përgatitja e proceverbalit dhe dorëzimi i turnit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës së manovrimit të parametrave të ngarkimit të furrës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse individuale në punë.
- të kryejë kontrollin fizik të vendit të punës, para fillimit të manovrimit me parametrat e ngarkimit të furrës;
- të marrë në dorëzim turnit e punës, sipas rregullit të caktuar;
- të lexojë me kujdes urdhërat dhe udhëzimet e lëna nga teknologu;
- të shtojë apo pakësojë ngarkesën e furrës në bashkëpunim me teknologun;
- të plotësojë siç duhet fletë-parametrin dhe kartelën e materialeve që hyjnë në furrë, sipas rubrikave përkatëse;
- të përgatisë procesverbalin dhe të dorëzojë turnin;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë gjatë punës së manovrimit të parametrave të ngarkimit të furrës.

RM 3 Kursanti manovron me parametrat për zgjatjen e elektrodave gjatë punës.

Përmbajtja:

- Veshja e uniformës dhe e mjeteve individuale të mbrojtjes në punë.
- Kontrolli fizik i vendit të punës.
- Manovrimi për zgjatjen e elektrodës në punë.
- Komunikimi me vëzhguesin për kontrollin e zgjatjes reale të elektrodës.
- Mbajtja e elektrodës pa lëvizur disa ne minuta pas cdo

zgjatjeje.

- Manovrimi për zgjatjen e elektrodave në mënyrë periodike.
- Manovrimi për zgjatjen e elektrodave në pjekje në rastet e këputjes në të butë dhe në të fortë.
- Manovrimi për zgjatjen e elektrodave në pjekje në rastet e shkurtimit të elektrodave gjatë punës.
- Regjistrimi i të dhënave të zgjatjes së pjesës së punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtje së mjedisit gjatë manovrimit me parametrat për zgjatjen e elektrodës në mënyrë periodike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet individuale të mbrojtjes në punë;
- të kryejë kontrolli fizik të vendit të punës, përpara manovrimit me zgjatjen e elektrodës;
- të manovrojë me buton përkatës për zgjatjen e elektrodës sipas udhëzimeve;
- të komunikojë me vëzhguesin për kontrollin real të zgjatjes së elektrodës, në mënyrë të vazhdueshme;
- të mbajë të palëvizur e elektrodës, për disa minuta, pas çdo zgjatjeje;
- të manovrojë me zgjatjen e elektrodës në mënyrë periodike, sipas udhëzimeve;
- të manovrojë me zgjatjen e elektrodës në pjekje në rastet e këputjes në të butë dhe në të fortë, sipas udhëzimeve përkatëse;
- të manovrojë me zgjatjen e elektrodës npjekje në rastet e shkurtimit të elektrodave gjatë punës;
- të regjistrojë saktë të dhënat e zgjatjes së pjesës së punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë manovrimit me parametrat për zgjatjen e elektrodës gjatë punës.

RM 4 Kursanti zbaton kartën teknologjike për kohën e derdhjes së materialeve të shkrira nga furra.

Përmbajtja:

- Veshja e uniformës dhe e mjeteve individuale të mbrojtjes në punë.
- Kontrolli fizik i vendit të punës.
- Kontrolli i harxhimit të energjisë elektrike para fillimit të derdhjes.
- Krahësimi i vlerës së harxhuar të energjisë me vlerën e caktuar në kartën teknologjike.
- Sinjalizimi i momentit të derdhjes së materialeve të shkrira nga furra.
- Lajmërimi i përgjegjës të turnit për fillimin e derdhjes.

- Manovrimi me elektrtodat për shoqërimin e derdhjes.
- Rregjistrimi i të dhënave të harxhimit të energjisë, pas derdhjes.
- Llogaritja e sasisë së energjisë së shpenzuar për një derdhje.
- Rregjistrimi i treguesve të tjerë pas derdhjes.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përcaktimit të kohës së derdhjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet individuale të mbrojtjes në punë.
- të kryejë kontrollin fizik të vendit të punës;
- të kontrollojë vlerën e harxhuar të energjisë elektrike para fillimit të derdhjes;
- të krahasojë vlerën e haexhuar të energjisë me vlerën e caktuar në kartën teknologjike;
- të sinjalizojë momentin e derdhjes së materialeve të shkrira nga furra, duke gjykuar mbi vlerën e harxhuar të energjisë elektrike;
- të lajmërojë gojarish apo me sinjale/kode, përgjegjësin e turnit për momentin dhe ecurinë e derdhjes së materialeve të shkrira nga furra;
- të manovrojë me elektrtodat për shoqërimin e derdhjes, sipas udhëzimeve përkatëse;
- të regjistrojë saktë të dhënat e harxhimit të energjisë elektrike pas derdhjes së materialeve të shkrira;
- të llogarisë sasisë e energjisë elektrike të shpenzuar për një derdhje;
- të regjistrojë, me përafërsi, treguesit e tjerë pas derdhjes, të tillë si: orari, numri i kovave, sasisa e prodhuar e metalit, sasia e prodhuar e skories etj;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përcaktimit të kohës së derdhjes.

RM 5 Kursanti stakon dhe ritakon furrën në raste avarish të rënda.

Përmbajtja:

- Veshja e uniformës dhe e mjeteve individuale të mbrojtjes në punë.
- Stakimi i furrës në rast se ndodh:
 - këputja e elektrodës;
 - rrjedhje e ujit në furrë;
 - rrjedhje e vajit në furrë;
 - rrjedhje e ujit glikol në furrë;
 - masë elektrike në sistemin e kapseve të elektrodës;
 - rrëshqitje e elektrodave etj;

- Identifikimi i avarisë së ndodhur në furrë.
- Lajmërimi i përgjegjësit të turnit dhe specialistit përkatës.
- Marrja e masave për eliminimin e avarisë.
- Ritakimi i furrës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë stakimit dhe ritakimit të furrës në raste avarish të rënda.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet individuale të mbrojtjes në punë;
- të stakojë furrën në raste të avarive të rënda si: këputja e elektrodës, rrjedhje e ujit në furrë, rrjedhje e vajit në furrë, rrjedhje e ujit glikol në furrë, masë elektrike në sistemin e kapseve të elektrodës, rrëshqitje e elektrodave etj;
- të identifikojë llojin e avarisë së ndodhur në furrë sipas treguesve të sinjalistikës dhe kontrolit me sy të lirë;
- të lajmërojë përgjegjësën e turnit dhe specialistin përkatës, për llojin e avarisë së ndodhur ;
- të marrë masat paraprake për eliminimin e avarisë, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të ritakojë furrën, në përputhje me udhëzimet përkatëse;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë manovrimit për stakimin dhe ritakimin e furrës në raste avarish të rënda.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e përpunimit të materialeve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore për regjistrimet periodike të parametrave kryesorë të furrës, ngarkimin e furrës, manovrimet për zgjatjen e elektrodave, zbatimin e kartës teknologjike për kohën e derdhjes së materiale të shkrira, si dhe stakimit dhe ritakimit të furrës në raste avarish të rënda.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për për regjistrimet periodike të parametrave kryesorë të furrës, ngarkimin e furrës, manovrimet për zgjatjen e elektrodave, zbatimin e kartës teknologjike për kohën e derdhjes së materiale të shkrira, si dhe stakimit dhe ritakimit të furrës në raste avarish të rënda, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur nga instruktoria po specialisti, dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Rekomandohet të organizohen dhe diskutimet në grupe në lidhje me detyrat që kryejnë kursantët.
- Instruktori duhet të kërkojë nga kursantët zbatimin me përpikmëri të rregullave të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi

	i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Mjedise reale të punës në repart. - Komplete të pajisjeve individuale mbrojtëse. - Modele të rregjistrave, fletë-parametrave dhe kartelave perkatës. - Pulti i komandimit. - Aparate matëse të parametrave kryesorë të furrës. - Rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.